

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“UMAFEA CONSULTING” SHPK

Ortakët:

Shoqëria “ **UMAFEA CONSULTING SHPK**” SH.P.K, është themeluar në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në mbështetje të ligjit Nr. 9901 datë 14/04/2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”, nga ortaku i vetëm:

Elisa Isufaj , shtetase Shqiptare , lindur me 29.11.1983 ne Berat dhe banues në Tirane Shqiperi madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i identifikuar nëpërmjet kartes ID me Nr I36129016B.

Shoqeria do te kryeje veprimtarine e saj ne perputhje me nenet e ketij statuti qe eshte njekohesisht edhe akti i themelimit te saj.

KREU I

Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Emërtimi

Shoqëria emërtohet “**UMAFEA CONSULTING SHPK**” SHPK, e cila është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar . Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër me vendimin e Asamblesë së Ortakëve sipas parashikimeve ligjore të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 2

Forma Ligjore

Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar (Sh.p.k.), ne baze te ligjit “Per shoqerite tregtare”

Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve sipas parashikimeve ligjore të nenit 214 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”.

Neni 3

Objekti i veprimtarise

Objek i veprimtarise,do te jete: **Ndërmjetësimi në tregtine e lëndëve djegëse, metaleve, mineraleve, dhe produkte kimike industrial. Aktivitetet e Ndërmjetësimit në Shitjen me Shumicë . Ky grup përfshin: aktivitetet e agjendave tregtare, të brokerëve të mallrave dhe të gjithë shitësit të tjerë me shumicë, që tregtojnë në emër dhe llogari të të tjerëve, aktivitetet e atyre, të përfshirë në prurjen bashkë të blerësve dhe shitësve, apo në ndërmarrjen e transaksioneve komerciale, përfshirë shitjen permes internetit. Aktiviteti sa me sipër duhet të kryhen në përputhje me dhe brenda kufijve të përcaktuar me ligj.Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi qe lidhet me veprimtarine e saj, i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.**

Neni 4

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Neni 5

Selia

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, Shqipëri, në adresën : **Njesia Bashkiake Nr.10 ,Rruga Myslym Shyri, Nr.Pasurie 4/201, Kati II,Tirane** .Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë edhe zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) Lekë, i derdhur tërësisht nga ortakët themelues të Shoqërisë.

Pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin e shoqërisë, pas themelimit është:

1. Elisa Isufaj , zoterues i 1(nje) kuote me vlerë të përgjithshme 100 (njëqind) Lekë, që përbëjnë 100% të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime. Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë. Pagesat e kontributeve në para do të vertetohet nepermjet mandatit arketimit pranë Shoqërisë.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga kuota ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar 3/4 (tre të katërtat) të votave të ortakëve, në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

Neni 7

Çertifikatat e kuotave

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një çertifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një çertifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i çertifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzimi i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në çertifikatën e kuotës. Çertifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, 3/4 mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar, 3/4 (tre të katërtat), e votave të ortakëve.

Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave prej 3/4.

Neni 9

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me *miratimitimin uninanim të ortakëve*.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë lirisht të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 10

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit..

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat “e” dhe “ë” të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

Asambleja e Përgjithshme ka kompetencë për ushtrimin e të gjitha tagrave të dhëna nga Ligji “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”. Mënyra e thirrjes, mbledhja dhe regjistrimi i vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme bëhen sipas dispozitave të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 11

Ndryshimet e Statutit

Ndryshimet e statutit vendosen nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 3/4 (tre te katertat) e pjesëve të kapitalit themeltar. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Zyrës së Qendrës Kombëtare të Biznesit për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Administrimi & Kompetencat

Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje.

2. Administrator i shoqërisë është **ELISA ISUFAJ**, shtetas Shqiptar, lindur me 29.11.1983 në Berat dhe banues në Tiranë Shqipëri.

3. Administratori ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë vijon:

a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatise dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, ti paraqese këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

i) Administratori i cili është ortaku i vetem i shoqërisë ka të drejtën e firmës nëpër institucione (p.sh. Banka, kontrata të lidhura me shtetin dhe organet qeverisëse dhe ato vendimarrëse,etj)

4. Në rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 të nenit 82 të ligjit “Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori është i detyruar të thërrase Asamblenë e Përgjithshme.

5. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Statuti ose rregulloret e tjera, të miratuara nga asambleja e përgjithshme, mund të parashikojnë ndryshe.

6. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 13

Përgjegjësitë

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme.

Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Ortaku që nuk është administrator, ka të drejtë në çdo kohë të informohet personalisht për veprimtarinë e shoqërisë dhe të njihet me llogaritë dhe dokumentet e shoqërisë.

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përgjithësisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni15

Bilanci i Shoqërisë dhe dividendet

Brenda 2 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendëve, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji, në raport me kuotat e zotëruara nga secili prej ortakëve.

Neni 16

Ekspertet

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

Neni 17

Bilanci Kontabël vjetor

Bilanci Kontabël vjetor, miratohet nga asambleja e ortakëve, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecantë etj.

Neni 18

Dividenti

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi, ortakëve të shoqërisë.

Neni 19

Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, edhe para plotësimit të afatit për të cilin është krijuar siç mund të jenë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;

d) me vendim të gjykatës;

dh) për arsye të tjera, të parashikuara në statut.

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”. Likuidatori është i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korrekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilëve shoqëria është kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve debive që shoqëria ka ndaj shtetit, shtetasve të veçante apo personave fizik apo juridik vendas apo të huaj.

Neni 20

Likuidatori

Afati i emërimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar pranë Zyrave të Qendrës Kombëtare të Biznesit

Neni 21

Regjistrimi i shpërbërjes

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, Gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim.

Neni 22

Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje apo konflikt që mund të lind gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht ortaket duhet ta zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërt çështja mund të behet objekt konflikti gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor përkatës.

Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, kompetente për zgjidhjen e tyre janë Gjykatat Shqiptare.

Neni 23

Ligji i aplikueshëm

Çfare nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut do të rregullohet në përputhje me dispozitat e ligjit “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 24

Pavlefshmëria

Në rast se ndonjë nga nenet e këtij statuti do të jetë i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm, atëherë ky nen nuk do të konsiderohet, ndërsa të gjitha nenet e tjera të këtij statuti do të mbeten në fuqi dhe të vlefshëm.

Neni 25

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 kopje me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortakët e Shoqërisë tregtare “**UMAFEA CONSULTING SHPK**” SH.P.K, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrat, mbiemrat dhe firmën e tyre origjinale.

Caktohet Administratori i Shoqërisë “ **UMAFEA CONSULTING SHPK**” SH.P.K ZNJ. **ELISA ISUFAJ** per kryerjen e regjistrimit te shoqërisë pranë Qendres Kombetare te Biznesit.

ORTAKËT THEMELUES:

ZNJ. ELISA ISUFAJ

TIRANE ME 21/03/2023